



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI
AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST
INFORMATION AND PRIVACY AGENCY



KONCEPT DOKUMENT

Udhëzues për Zhvillimin e Testit të Dëmit dhe Interesit Publik

11 shtator 2020

Nevoja për hartimin e udhëzuesit për zhvillimin e testit të dëmit dhe interesit publik rrjedh nga domosdoshmëria që kufizimet në të drejtën për qasje në dokumente publike të jenë proporcionale. Ky dokument i karakterit udhëzues ka për qëllim lehtësimin e punës së zyrtarëve të institucioneve publike me kompetenca vendimarrëse në zbatimin e Ligjit Nr.6/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, gjatë shqyrtimit, respektivisht refuzimit apo aprovimit të pjesëshëm të një kërkesë për qasje në dokumente publike të adresuar në institucionin publik që përfaqësojnë ata. Fakti që ky ligj ka paraparë aplikimin e këtij testi, dëshmon fuqinë që bartë në vete kjo e drejtë e qytetarëve.

Normalisht, një test i dëmit mund të konsiderohet i qëndrueshëm dhe efektiv kur është detyrues, aplikohet ndaj të gjitha përjashtimeve, favorizon publikimin dhe përcakton kriteret përkatëse për t'u marrë parasysh.

Aplikimi i këtij testi u mundëson institucioneve publike që të marrin vendim të veçantë për çdo rast individual, sepse çdo kërkesë për qasje, pavarësisht ngjashmërive që mund t'i ketë me rastet tjera, është specifik në vete.

Balancimi i interesit publik, për sa i përket publikimit të një dokumenti publik¹ të caktuar mund të ndryshojë me kohë, si dhe faktorët pro dhe kundër publikimit duhen peshuar në përgjigje të secilës kërkesë që pranohet.

Testi i dëmit dhe interesit publik bëhet para se të merret vendimi nga institucioni publik për aprovimin e pjesëshëm apo refuzimin e një kërkesë për qasje në dokumente publike, me ç'rast përcaktohet nëse interesat e mbrojtura me ligj mbisundojnë interesin publik ndaj publikimit të dokumenteve publike.

Interes i mbrojtur me ligj konsiderohet mbrojtja e:

- jetës së njeriut, shëndetit dhe sigurisë publike;

¹ Dokument Publik- nënkupton çdo akt, fakt apo informatë në formë elektronike apo me zë, formë të shtypur, në incizime vizuale apo audiovizuale të prodhuara apo mbajtura nga institucioni publik;

- sigurisë shtetërore, mbrojtjes dhe marrëdhënieve ndërkombëtare;
- parandalimit, hetimit dhe ndjekjes së veprave penale në rastet kur publikimi i dokumenteve publike mund të dëmtojë procesin e hetimit;
- hetimet disiplinore, në rastet kur publikimi i dokumenteve publike mund të dëmtojë procedurën disiplinore;
- inspektimit, kontrollimit dhe mbikëqyrjes nga institucionet publike në rastet kur trajtojnë informacion të klasifikuar;
- të drejtës për privatësi dhe të drejtës së fshirjes ('e drejta për t'u harruar');
- konfidencialitetit komercial, siç janë sekretet e biznesit, sekretet profesionale apo të kompanisë;
- dokumenteve për të cilat institucioni publik apo palët e treta gëzojnë të drejtat e pronësisë intelektuale;
- politikave ekonomike, monetare dhe këmbimore të shtetit;
- konfidencialitetit statistikor;
- barazisë së palëve në procedura gjyqësore dhe administrimin efikas të drejtësisë;
- diskutimeve brenda apo ndërmjet institucioneve publike lidhur me shqyrtimin e ndonjë çështjeje, e cila përbën dokument të klasifikuar.

Në kuadër të testit të dëmit, institucioni publik duhet të demonstrojë që publikimi rrezikon t'i shkaktojë dëm një interesi të mbrojtur, në mënyrë që ta arsyetojë refuzimin apo aprovimin e pjesëshëm. Aplikimi i proporcionalitetit kërkon veprime balancimi, ku dëmi i publikimit mbisundon ndaj interesit publik.

Zhvillimi i testit të dëmit nuk shihet i arsyeshëm në rastet kur kërkesa për qasje në dokumente publike lidhet me:

- shpenzimet e parasë publike;
- zbatimin e funksioneve publike ose marrëdhëniet e punësimit të zyrtarëve publikë, përveç në rastet kur ka të dhëna personale të mbrojtura apo kur saktësohet ndryshe në ligjet përkatëse;
- mjedisin, mbeturinat, substanca të rrezikshme ose informata të raporteve të sigurisë në mjedis, ashtu siç janë të parapara me ligjin përkatës për mbrojtjen e mjedisit.

Hartimi i këtij udhëzuesi është i domosdoshëm për ta rritur efikasitetin e institucioneve publike në zbatimin në praktikë të Ligjit për Qasjen në Dokumente Publike. Refuzimet e deritanishme nga institucionet publike ndaj kërkesave të qytetarëve, në numër të konsiderueshëm, janë paraqitur si rrjedhojë e njohurive të pakta të kriterëve të ligjit përkatës, pasigurisë për vendimarrje, mungesës së mekanizmit detyrues, përmes një autoriteti, siç është sot Agjencia për Informim dhe Privatësi.

Përmes këtij dokumenti të karakterit udhëzues për zyrtarët përgjegjës² (sipas paragrafit 1.12 të nenit 3 të LQDP) të hartuar nga AIP, synohet:

² Zyrtar Përgjegjës - nënkupton zyrtarin më të lartë administrativ të institucionit publik [zyrtarin kryesor administrativ: sekretarin e përgjithshëm / kryetarin e komunës / kryeshëfin ekzekutiv / drejtorin e përgjithshëm / kryesuesin e bordit], i cili është përgjegjës për vendimarrje në kuadër të një institucioni publik.

- ✓ rritja e efikasitetit të shqyrtimit të kërkesave të adresuara në institucionet publike;
- ✓ rënia e numrit të refuzimeve (të pabazuara);
- ✓ aplikimi i përpikët i procedurave të shqyrtimit të kërkesës deri te vendimarrja;
- ✓ ngritja e nivelit të llogaridhënies nga institucionet publike ndaj autoritetit të apelit;
- ✓ rënia e numrit të kërkesave për këshilla nga institucionet publike për AIP-në;
- ✓ rritja e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve publike;
- ✓ rënia e numrit të ankesave të paraqitura në AIP.

Hartuar nga:

Udhëheqësi i Shtyllës për Qasje
në Dokumente Publike



Jeton ARIFI